2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i Raportit finciar për periudhen janar-dhjetore 2024,
4. Përmisimi i Vendimit nr.02/24/2024 i datës 26.11.2024 mbi Normat Tatimore për vitin 2025,
5. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Kryetarit për vitin 2024,
6. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024,
7. Shqyrtimi i Raportit të Punës së KKSB\_së për vitin 2024,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së KKSB\_së për vitin 2025,
9. Përmirësimi i Vendimit nr.02/23/24 i datës 30.12.2024 Rregullorja për Transparencë 2024-2028 dhe Planit i Veprimt sipas rekomandimeve të ministrisë së linjës,
10. Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit të Punës për të drejtat e fëmijëve,
11. Shqyrtimi dhe Miratimi i planit të punës të Komitetit për Komunitete,
12. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit dhe
13. Të ndryshme.

Rendi i ditës miratohet me 13 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,

z.Shpejtim Gacaferi, për këtë mbledhje mungojnë dy anëtarë, znj.Lirjeta Shehu-LDK dhe znj,Erleta Qestaj-AAK.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka e qes në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar, kush është për, për 13 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbali i bledhjes së kaluar u miratua.

3. Shqyrtimi i Raportit finciar për periudhen janar-dhjetore 2024,

Sqarimin dhe arsyetimin e raportit finciar për periudhen janar-dhjetore 2024 e bëri z.Arten Hamza, zyrtar i lartë për buxhet në DBF, i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit me pas e sqaroi dhe e arsyetoje raportin finciar janar-dhjetore 2024 para anëtarëve të kuvendit.

z.Leonard Llojuni, përshëndeti për të gjithë, une isha ndale në faqe 14, ku thotë ndertimi i sheshit qender në komunën e Junikut, alukime 124000€, ndërsa shpenzime 124000€, ktu të na shpjegoni se në qender të junikut nuk kemi kurrfarë sheshi të ndërtuar deri më tani, qeshtja tjetër është vendosja e kamerave të siguri, që është postuar edhe nga kryetari në facebook, është në vlerë prej 24000€, kamerat kanë qenë të vendosuar edhe më parë dhe nuk ka nevojë të bëhet film,

ndriqimi i hapsirave publike pergjate shtratit te lumit Erenik, ne vlere prej 10000€, dhe kur shohim nuk ka asnje drite e re nuk eshte vendosur pergjate shtratit te lumit Erenik, tjeter kemi ne faqen 11 pagesat vendime gjygesore ne vler prej 173000€, mirembajtja e rrugeve lokale 12420€ dhe mirembajtja rutinore, po du te keme sqarime per keto dy qeshtje, kjo mirembajta rutinore nuk ka qene me heret si kode, po ashtu eshte e pa kjarte edhe sherbimet tjera kontratuese, sherbimet kshilledhense dhe profesionale ne vlere 10000€ per çka behet fjale.

z.Arten Hamza, po nisna nga qeshtja e pare, nese e shikone te faqeja 12, ne funde te faqes 12 e ke shpenzimet sipas vendimet gjygesore permbarusore te ekzekutuara per vitn 2024 jane ne vler prej 215245.63€ keto jane ekzekutuar ne page ne arsimin e ulete dhe te mesem shkollore, 40736€, ne kategorine e subvencioneve 1224€, kurse ne kategorin e investimeve kapitale ne vler prej 173284€ qe ne totale jane 215245€, sa i perkete projekteve ne tabele eshte e sqaruar kjo vlere prej 173284€ te cilate jane mare nga investimet kapitale, edhe poshte tabele ne paragrafin e dyte eshte dhene sqarime per kete shume te mjeteve.

z.Ruzhdi Shehu, pershendetje te per te gjithë, per shkakë te kontrates kolektive per arsime na jane trehekur te gjithë keto mjete qe jane pare ti kemit te perfunduara keto projekt, kto mjete jane terhekur nga permbaruesi me vendime gjygesore dhe nuk kemi mundur ti ndalojme, keto mjete eshte dashur qeveria e vitit 2017 ti mbuloje keto mjete, nuk eshte problem ky vetem i komunes se Junikut por eshte per te gjitha komunat.

z.Lulzim Gacaferi, pershendetje per te gjithë, qeshtja ka te beje me vendosjen e kamerave te siguris dhe mua po me intereson te di se a jane ne funksion keto kamera dhe a menaxhohen nga komuna apo nga Policia e Kosoves, qeshtja tjeter eshte lidhur me mbeturina interne kush e bene grumbullimin e ketyre mbeturinave.

z.Ruzhdi Shehu, kemi filluar me kamrat e sigurise, jane duke funksionuar dhe monitorimin e tyre e bene Policia e Kosoves, dhe ne do te vazhdojme vendosjen e ketyre kamerave te sigurise edhe ne vende rruget tjera te komunes sone, ndersa sa i perkete deponis se mbeturinave inerte, ne kei nje bashkpunim me GIZ-Gjerman , qe kemi filluar me ndertim e fazes se pare te kesaje deponie per mbeturina inerte dhe dhe te produkteve (Mobileve), kjo eshte faza e pare dhe presim perkrahje nga GIZ-Gjermane te na ndimoje edhe per fazat tjera ne kete vit.

z.Lulzim Gacaferi, e ceki edhe z.Leonard Llojluni, ndertimin e sheshit qender ne komunën e Junikut a mundesh nje sqarim shtese lidhur me kete projekt.

z.Ruzhdi Shehu, ne e kemi planifikuar kete projek dhe vetem sa e kemi qitur ne tender menjehere me pesë (5) vendime gjykata dhe thesari na i kanë tërhekur mjete e këtij projekti dhe projekti eshte nderprer.

z.Zenel Maloku, përshendetje për të gjithë, unë uroj që gjykata ta ndërpret këtë tërhekje të mjeteve, sepse si ja paska nisur nj ditë do të mbesim pa paga, kështu qysh po na prezentohet nuk e paskemi punën mirë me këto gjykata, për ditë është duken na i terhekur mjetet qe ne i kemi paraparë për projekte, dhe mua po me intereson se si do të përfundoj kjo çështje.

z.Ruzhdi Shehu, edhe këtë vit do te na i terhekin mjete dhe do të përfundoje, sepse shkëputja e

kontratës kolektive është berë në vitin 2022 dhe nuk do të respektohet me nga ana gjygjësore.

z.Leonard Llojuni, unë qëllimisht e ngrita si çështje këtë projektin e ndërtimit të sheshit në qendër, sepse unë e kam ditur se mjetet për këtë projekt janë terhekur nga përmbaruesi, por ne gjithë e kemi pyetur kryetarin për këtë projekt në mbledhjet e kaluara dhe na është përgjigjur se janë në fazën e projektimit, ekzitojnë procesverbalet, ndërsa sa i përket kamerave të sigurisë, këto kamera të sigurojnë janë vendosur edhe nga pushteti i kaluar, tri kamera kanë qenë të dëmtuar nga operatorë të ndryshëm, kurse tani kemi prapë vendosjen e kamerave të sigurisë në vlerë prej 24000€.

z.Rrustem Pepshi, menaxheri i kontratës vendosja e kamerave të sigurisë, përshëndetje për të gjithë, komuna e Junikut ka lidhur kontratë me operatorin ekonomik për tri vite, dhe në bazë të kësaj kontrate në marrim pagesë aq sa kemi nevojë, kur kemi dalur në terren e kemi vërejtur se komplet kabllat e kamerave është e keputur po ashtu kemi vërejtur që ka kamera që janë vjedhur përpos kësaj kemi gjetur kamera që janë djegur nga sistemi i rrymës pasi që kanë qenë të lidhura, tash kemi vendosje të kamerave komplet të reja dhe i kemi zavesuar ato që kanë qenë jashtë funksionit kemi kabllat të re për të gjitha kamerat dhe pajisjet tjera dhe për momentin janë duke funksionuar dhe këtë vit do të vazhdojmë me vendosjen e kamerave të sigurisë edhe në pjesë tjera të komunës sonë.

z.Dervish Bajraktari, përshëndetje për të gjithë, sa i përket projekti të ndërtimit të sheshit në qendër, zakonisht kemi bërë pyetje edhe në mbledhjet e KPF-se, dhe ti kryesues na je përgjigjur se projekti ndërtimi i sheshit në qendër është finalizuar dhe ne kemi kërkuar të na e prezantojmë këtë projekt dhe keni thenë se do ta prezantojmë në mbledhjen e kuvendit, po bodhen dy mbledhje të kuvendit që po mbahen dhe ende nuk e kemi prezentuar këtë projekt, dhe tash kur vije të ndërtimi i sheshit na dël se mjete e parapara për këtë projekt i ka terhekur përmbaruesi, me cilat mjete e keni bërë projektin e sheshit të qendrës, dhe a do të perfundojë ndërtimi i sheshit të qendrës a jo apo kanë qenë vetëm llafe.

z.Ruzhdi Shehu, është bërë dizajni i qendrës jo projekti, pjesa e disanjimit hartues është bërë në mbështetje të fakultetit të Arqitekturës dhe për këtë nuk kemi bërë asnjë pagesë është kryer pa pagesë nga ana e ekspertëve, profesorëve dhe të studentëve të fakultetit të arqitekturës, pjesa e projektit zbatues na është prezentuar në mënyrë elektronike por jo edhe në mënyrë fizike.

z.Lulzim Gacaferi, këtu po debatohet për sheshin e qendrës së Junikut si projekt nga LDK dhe AAK, por këtë projekt e kemi harruar nëse si LVV dhe për këtë edhe kemi nënshkruar koalicion me LDK që ta ndërtojme sheshin në qendër të Junikut, unë ju them juve eja e merenë dhe ekzekutivën dhe nëse ju duhet ndima e jonë jemi të gatshëm të ju ndihmojmë mos harroni energji kot.

z.Xhemë Tofaj, përshëndetje për të gjithë, në mbledhjen e KPF-se kemi kërkuar që të na e sillni një raport për pagesat e avokatit, tërë këto lëndë që janë po na intereson të dimë se sa lëndë i ka hupur sa i ka fituar çka ka mbrojtur sa seanca ka mbajtur? Është një shumë prej 8388€.

znj.Leonora Shehu, përshëndetje për të gjithë, është e vërtetë që kemi thenë që do të ja sillim raportin, për momentin menaxherja e kontratës është në pushim kështu që në muajin e ardhshëm

do ta keni këtë raport.

z.Dervish Bajraktari, po nderlidhem me z.Lulzim Gacaferi, sa i perkete projekti ndertimi i sheshit ne qender te Junikut nuk eshte se po debatojme mes LDK dhe AAK por po debatojem se eshte ne interes te qytetarve te Jomunes se Junikit, e sa i perkete projekti qe ju po thuni ne e kemi pare ne kohen e fushates dhe po shkojne tri vite e ju si bashkqeverisje nuk keni marre hapa qe ti sjellni mjete nga qeveria e ky projekt te perfundoj.

z.Demokrat Ganijaj, pershendetje per te gjithë, po me duket se eshte duke u bere fushate sepse kan then se kan investuar 100000000€.

z.Leonard Lolluni, eshte e verte se kryetari i LVV qendra ne Junik ka postura ne facebook se qeveria Kurti per keto kater vite ka investuar 100000000€ ne komune e Junikut dhe une po du te di se ku jane keto investime.

z.Lulzim Gacaferi, faleminderit z.Dervish Bajraktari qe e ceke bashkeqeverisjen, po eshte e vertet qe ne kemi pas nje kualicion LVV-LDK per qeverisje ne komune e Junikut dhe kjo eshte bere per ta quar ne shtepi pushtetin e kaluar dhe mire kemi bere, por me pas qendra e LVV nuk e ka miratuar kete kualicion dhe prej atherit nuk ka kualicion ne mes LDK-LVV, por per kunderkesaj yne jam i gatshem qe ta ndimoj çdonjeri qe beni pune te mire per Komune e Junikut dhe qytetaret e saj, pa mare parasysh se kush qeveris.

znj.Rajmonda Krasniqi, pershendetje per te gjithë, une shprsoj te realizonehen keto miljona qe u folen por po me duket se pika e trete e rendi te dites eshte raporti finaciar janar-dhjetore 2024, keshtu qe te fukusohemi per keto qe kemi perpara.

z.Zenel Maloku, une ketu nuk jame per fushat sepse pasi ta krye kete mbledhje do te shkoj ne shtepi, por çka eshte e dhimshem eshte se gjithë kjo shume qe u fol te dihet se çka ka ndodhur me gjithë kete shume kjo eshte e dhimshme, andaj neduhet te punojme te gjithes sbashku, sepse Juniku nuk eshte vetem i kryetari si persona po as i zeneli, por eshte i te gjithë qytetarve te kesaj Komune, te gjithë duhet te punojme ndershem me dinjtet dhe me na ndodhe kjo jo na mur gjykata kaq jo permbaruesi kaq.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese tjeter nuk ka kalojme ne piken e radhes te dites.

#### 4. Përmisimi i Vendimit nr.02/24/2024 i datës 26.11.2024 mbi Normat Tatimore për vitin 2025,

Sqarimin dhe arsyetimin e permisimit te venimit nr:02/24/2024 i dt:26.11.2024 mbi normat tatimore per vitin 2025 e beri znj.Saranda Isufaj, menaxhere e tatimit ne prone ne DBF, e cila fillimisht i pershendeti te gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoi permesimin e venimit para anetarve te Kuvenidit.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese nuk ka e qes ne votim kush eshte per, per 13 vota, kunder 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se permisimi i vendimit me nr:02/24/2024 i dt.26.11.2024 u

miratua.

5. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Kryetarit për vitin 2024,

Sqarimin dhe arsyetimin e raportit të punës së kryetarit për vitin 2024 e bëri Kryetari Komunes z.Ruzhdi Shehu.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese nuk ka kalojme në piken e radhës të rendit të dities.

6. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024,

sqarimin dhe arsyetimin e Raportit të Punës së Kuvendit Komuna për vitin 2024 e bëri z.Shpejtim Gacaferi, kryetar i Kuvendit Komunal Junik.

Kerkese nuk pate

7. Shqyrtimi i Raportit të Punës së KKSB\_së për vitin 2024,

Sqarimin dhe arsyetimin e raportit të punës së KKSB\_se për vitin 2024 e bëri nënkryetari i Komunes së Junikut z.Besart Tofaj kordinator i këtij keshilli, i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë e më pas e sqaroi dhe e arsyetoi raportin e KKSB\_se para anëtarëve të kuvendit.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese nuk ka kalojme në piken e radhës të rendit të dities.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së KKSB\_së për vitin 2025,

Po ashtu plani i punës të KKSB\_se për vitin 2025 e sqaroi dhe e arsyetoi para anëtarëve të kuvendit nënkryetari i Komunes z.Besart Tofaj- kordinatore i KKSB\_se

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese nuk ka e qes në votim plani i punës së KKSB\_se për vitin 2025 kush është për, prezent në sallë të kuvendit janë 11 anëtarët e Kuvendit, për 11, kundër 0 dhe abstenim 0, konstatoi se plani i punës së KKSB\_se për vitin 2025 u miratua.

9. Përmirësimi i Vendimit nr.02/23/24 datës 30.12.2024 Rregullorja për Transparencë 2024-2028 dhe Plani i Veprimit sipas rekomandimeve të ministrisë së linjës,

Sqarimin dhe arsyetimin e përmirësimit të Vendimit nr.02/23/24 datës 30.12.2024 Rregullorja për Transparencë 2024-2028 dhe Plani i Veprimit sipas rekomandimeve të ministrisë së linjës, e bëri znj.Leunora Shehu.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese nuk ka e qes në votim përmirësimi i Vendimit nr.02/23/24 datës

30.12.2024 Rregullorja për Transparencë 2024-2028 dhe Plani i Veprimit sipas rekomandimeve të ministrisë së linjës, kush është për, për 11 vota kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota konstatohet se miratimi i vendimit u miratua.

#### 10. Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit të Punës për të drejtat e fëmijëve,

Sqarimin dhe arsyetimin për miratimin e planit të punës për të drejtat e fëmijëve e bëri z.Fatos Shala, derjtor në DSHMS, i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë dhe më pas e sqaroi dhe e arsyetoi para anëtarëve të kuvendit planin e punës për të drejtat e fëmijëve.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka e qes në votim planin e punës për të drejtat e fëmijëve, kush është për, për 11 vota kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota konstatohet se plani i punës për të drejtat e fëmijëve u miratua.

#### 11. Shqyrtimi dhe Miratimi i planit të punës të Komitetit për Komunitete,

Sqarimin dhe arsyetimin e planit të punës të komitetit për komunitete në mungesë kryesues se këtij komiteti e bëri z.Shpejtim Gacaferi, kryetari i kuvendit komunal.

z.Zenel Maloku, në edhe në mbledhjen e fundit e kemi patur si pikë të rendit të ditës, këtë plan pune të komitetit për komunitete dhe në planin e fundit të prezentuar kemi patur e parapare 10 mbledhje për vitin 2025 dhe njëra ndër to ka qenë e parapare të mbledhet në dhjetor 2025 dhe kjo nuk do të mbahet, dhe pas takimit të këtij komiteti jemi dakorduar që mbledhja e dhjetorit të mbahet o në janar 2025 o në gusht 2025, dhe me sa di i vetmi ndryshim është ky ndryshim nga plani i punës që kemi prezentuar në mbledhjen e kaluar.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka e qes në votim planin e punës të komitetit për komunitet për vitin 2025 kush është për, për 11 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatohet se plani i punës për komitetin për komunitete për vitin 2025 u miratua.

#### 12. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit

z.Zenel Maloku, une dua ta pyes kryetarin e komunes se ku e ka patur traktorin e komune me këto data, 17,18,19,20,21,22,23,24.

z.Ruzhdi Shehu, në teren ka qenë.

z.Zenel Maloku, në rrugë e kemi patur për një javë të tërë, në rrugë trup, por siq po shihet nuk kemi dijeni as ku e kemi patur, andaj më mirë do ishte të përgjigjeni se nuk e dini.

z.Mursel Salihaj, përshëndetje për të gjithë, desha të pyes, kompania Hidrodrini kur bëjnë intervenime në rrugë, a bëjnë kërkesë për lene në komune a jo.

z.Ruzhdi Shehu, po e ka per obligim qe te parashtroi kerkese ne komune dhe te paiset me pelqim nga komuna per ate intervenim.

z.Lulzim Gacaferi, ne kemi disa raste ne lagjen Gacafer kane pre asfaltin per interveni dhe e kane lane ashtu pa e pru ne gjendje se si ka qene para intervenimit, kjo eshte evidente munde te dokumentohet se ende jane ashtu qe nga intervenimi, edhe une kerkoj qe ujsjellsin ne te ardhmen ta menagjoj Komuna, sepse tani kemi edhe ngritje te tarfave ne fature, kemiedhe shebimin per ujra te zeza, dhe kjo eshte e pa pranushme, une ka 20 vite qe jetoj ne perendim dhe ujrata e zeza jane te ndara eshte si sherbim i veqant dhe nuk llogaritet ashtu siq shpenzon per ujra te pastra edhe per ujra te zeza, andaj kerkoj qe kjo te rishikohet dhe qytetaret te mos demtohen ne aspektin finciar.

z.Ruzhdi Shehu, qeshtja e tarifave eshte qeshtje e agjencionit te entit rregullativ per ujin e pijes dhe per ujitjen e tokave, jane dy institucione te pa varaura e qe menxhohen nga qeveria qendrore, qeshtja e dyte eshte se kompania Hidrodrini kur mere pelqimin nga komuna per intervenim ajo eshte e obliguar ta kthen gjendjen ashtu siq ka qene, por ndoshta per keto raste qe po flitni ndoshta kan ndikuar kushtet atmosferike dhe kan mbetur ashtu, per ndryshe e kan obligim qe ta kthejne gjendjen siq ishte.

z.Lulzim Gacaferi, kryetar une e di se ne vitet 90\_ta keni qene shume i angazhuar qe ta kemi kete ujsjells qe sot e kemi dhe ky investim eshte investim i qytetarve te kesaj komune , nuk na ka sjelle askush tjeter kete ujsjelles , as Hidrodrini dhe askush tjeter, andaj une kerkoj qe ky ujesjells te menaxhohet nga komuna jone, dhe pyetja eshte ne aspektin Juridik a na lejohet qe neve si komune ta menaxhojme kete ujesjells.

z.Ruzhdi Shehu, kete vite priten qe nga Hidrodrini te investohen rrethe 80000€ ne kanalizim, dhe per ta ndryshuar ket qe po kerkoni duhet te ndryshoje ligji ne nivel vendi dhe per momentin eshte e pa mundur.

### 13. te Ndryshme

z.Lulzim Gacaferi, keto dite per vizite ne Junik ka qene Kryeministri i Kosoves, ktu nekullen e Hoxhajve, dhe ai ishte i perkushtuar qe ne kete zone te kete zhvillim te turizmit, dhe une e kam pytur kryeministrin qe a eshte e mundur qe ne bashkepunim me korporaten energjetike ta sjellin ne bjeshte edhe rrjetin energjetik, qe ne ate zone te kete zhvillim, dhe mua po me intereson se komuna a ka bere ndonjeher kerkese qe korporata energjetika ta shtri rrjetin energjetik edhe ne ate pjese, pra ne Bjeshket e Gjeravices.

z.Ruzhdi Shehu, dy kerkesa i kam dergu, nje ne vitin 2022 dhe tjetra ne vitin 2023, bile kemi investuar ne infrastrukturen e tyre ku kemi lene gypat per futjen e kablllove, por problemi eshte te ZRA\_Ja dhe te KEDS qe nuk eshte e qarte se cila duhet ta shrie rrjetin, por ne prape do te kerkojme dhe jemi te gatshem edhe ne te investojme vetem e vetem qe ta kemi rrjetin elektrin edhe ne ate pjese pra ne bjeshkete Junikut.

z.Zenel Maloku, mua me pelqej kerkesa nga z.Lulzim Gacaferi, ke shume me vende, nese do te ndodhte do ishte nje pune shume e mire qe ndodhe,por ajo qe nukme pelqej se thate se anetari i kuvendit ka te drejte te pyes dhe jo te futet ne biseda, por edhe kur te pyesim pergjigjeja duhet ti kthehet ne kohe reale dhe e drejte, dhe jo te behet hajgare me parashtruesin qe shtrone pyetje, ose nese nuk e dini pergjigjen te thuani se nuk e di, kjo nuk eshte edhe marre me tha se nuk e di,

z.Lulzim Gacaferi, meqe e kemiketu drejtorin e urbanizmit po dua te pyes lidhur me projektin e e segmentit te rruges Qender-Rastavic, kam vrejtur se ka shume shtylla te ndriqimit publik, a eshte keshtu edhe ne projekt, sepse kto shtylla duhen te jene te vendosura jashte trotuarit dhe jo ne ate menyre siq jane tani te vendosura ne trotuar dhe afer rruges, dhe meqe pune ende nuk jane kryer do ishte mire qe te intervenohet dhe keto shtylla te zhvendosen ne pjesen ku nuk ka trotuar dhe ne kete menyre edhe kamsoret do ta kene te lire trotuarin per ecje por edhe ndriqimi do ishte i njejt, une kame shetiruar shume neper perendim dhe kete qe e pashte ketu nuk e kam pare askund, une kerkoj qe te bisedoni me operatorin ekonomik dhe ta ri shikoni projektin, te vendosin shtyllat ku duhet dhe te mos kemi probleme ne te ardhmen, dhe une besoj se nese lidhen ne kete menyre siq jane ne te ardhmen te shkurte mbi 60% te tyre do te demtohen, qeshtja tjeter ka te beje me nje rruge ne fshatin Gjocaj, rruga eshte te Ganijajt dhe shkone ne drejtim te shtepise se mesuesit z.Avdyl Gjocaj, keta banore kane bere kerkese me 24.10.2024 ne komune qe kesaj rruge ti vendoset emertimi i z.Avdyl Gjocaj, ai ishte veretan i mesimit, veteran i UÇK-se, dhe pergjigje ende nuk kan mare dhe po dua te di se a keni ndermar diqka ne kete drejtim, apo duhet qe ne ne kete kuvend te vendosim dhe kete rruge ta emertojme me emrine mesuesit Avdyl Gjocaj.

z.Zenuk Shala, pershendetje per te gjithë, ne e kemi mare projetin e rruges Junik-Rastavice ashtu siq jane te vendosura shtyllat, projektin jane duke e menaxhar, menaxheri i komunes dhe eksperti nga ana e ministris, dhe as menaxheri i komunes por as eksperiti i caktuar nga ministria nuk kane ber vrejte per vendosjen e shtyllave, dhe problemi eshte me ngasit e veturave nuk eshte problemi i shtyllave, deri tani eshte punuar sipas projekti dhe kete mendim qe e ceket ne mund ta diskutojme edhe me ekspertet tjere.

z.Lulzim Gacaferi, ju po thoni se ngasit jan problem, por prap edhe per kunder kesaj shtyllat nuk jane te vendosuar ne menyre adekuate, nuk jane te vendosura sipas standarteve.

z.Zenuk Shala, sa i perkete emertimit te rruges ne fshatin Gjocaj, drejtoria e Urbanizimi eshte e thirrur te meret me emertimin e rrugeve, kerkesen nuk e kam marr, diku ne komune eshte ajo kerkese por une deri tani nuk e kam mare, mire por qe te emertohet nje rruge duhet qe te jene dhjete shtepi te nderuara qe ne te kemi te drejte te te kerkojme nga agjencioni kadastral qe te kete emertim ajo rruge.

z.Lulzim Gacaferi, une nuk e di sa shtepi ka ajo rruge, por meqe kam biseduar me familjar e tyre e kam ndije si obligim qe ta ngrehi si qeshtje kete kerkese te tyre ketu ne kuvend, sepse mesuesin z.Avdyl Gjocaj e kam pasur mesues por edhe bashke luftetar, dhe mendoj se ky kuvend duhet te beje te pa mundren qe rruga atje te emertohet me emrin e Mesuesit z.Avdyl Gjocaj.

z.Zenel Maloku, une e perkrahi kerkese e z.Lulzim Gacaferi, eshte e drejt, edhe rruga ne fshatin Jasiq nga laura eshte e emeruar dhe ka shtepja por banore nuk ka po ashtu edhe ne Gjocaj ka

shume shtepi por banor nuk ka, andaj edhe une them qe kuvendi te mar vendim dhe kjo rruge te emertohet me emrin e z.Avdyl Gjocaj.

z.Zenun Shala, ka kërkesa edhe tjera dhe drejtorja e Urbanizimit do ta formoj komisioni e ben vendimin dhe ai vendim vjen ketu ne kuvend do te vendoset, qe i bie se do ti marim parasyshe te gjitha kërkesat.

z.Xheme Tofaj, desha te nderlidhem me projektin e rruges Junik-Rastavic, drejtori tha se projektin e kemi mare dhe po dua te di nga kush e ka mare sepse ketu krenohen se kete projekt vet e kan bo.

z.Zenun Shala, projektin e kemi mare nga projektanti qe e kemi angazhuar ne si komune.

z.Lulzim Gacaferi, si nuk e keni vërtetur kete ne projekt dhe aty te jepni vërtetje, menaxheri i komunes a eshte menaxheri i fushes adekuate,sepse ai do ta kishte vërtete kete defekt.

z.Zenun Shala, menaxheri i komunes nuk eshte i kesaj lomie, mire por eksperti i qeverise eshte i lamise adekuate.

z.Shpejtim Gacaferi, e shpalli te mbyllur mbledhjen e Janar-2025

Procesmbajtësi:  
z. Esat Hoxha

---

Kryesuesi i Kuvendit:  
z. Shpejtim Gacaferi

---